REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. Dep. Dep. Z-D/DPK
Nr. Prot Br.Prot Prot No. 01-4928/15
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages 02
Data Datum Date 28.12.2015
PRISHTINE

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

---

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.12.2015, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti** me nr. AKK– 03-02-4177/15, për **z. Binak Kryeziu – Auditor i Brendshëm në Komunën e Rahovecit**, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

**I.** Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për z. Binak Kryeziu – Auditor i Brendshëm në Komunën e Rahovecit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Kryeziu është hetuar për konflikt interesi sepse krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë publik, ka qenë pronar i vetëm në biznesin privat N.T.SH. “Albani”.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht zyrtarit i ka dërguar shkresën zyrtare me të cilën e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e Agjencisë.

z. Kryeziu është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do caktoj një person të autorizuar në biznesin privat në mënyrë që të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të autorizuar në biznesin privat “Albani”. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

**II.** Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

REPUBLIKA E KOSOVËS * AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT * ANTI-CORRUPTION AGENCY * REPUBLIC OF KOSOVO * AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE * REPUBLIKA KOSOVA